

Një person vuante nga një sëmundje tumorale dhe u trajtua me medikamente mjekësore, por më vonë diagnostifikohet përsëri me këtë sëmundje, dhe mjekët thonë se ka ‘**relapse**’ (**rikthim**).

Gjithashtu, në anën tjetër, kemi një shkelës penal të mëparshëm, i cili përsëri kryen një vepër tjetër penale dhe juristët thonë se është ‘**recidivist**’ (**përsëritës**). Çfarë mund të ndodhë nëse pacientin me tumor e kap një i ftohtë (thjesht grip)? A është ai i sëmurë përsëri? A ka “relapse” ai? A ka ai rikthim në gjendjen e mëparshme shëndetësore? Çfarë ndodh me shkelësin penal kur ai kryen përsëri të njëjtën vepër penale? Çfarë ndodh me shkelësin penal kur ai kryen një tjetër vepër penale?

Pavarësisht nga dallimi dhe vështirësitë, në “sjelljen” e trupit dhe mendjes njerëzore shoqëritë moderne sot ofrojnë “ilaçe” dhe “metoda” të kurimit të gjendjes (kjo tryezë, besoj, nuk bën as më shumë e as më pak po të njëjtën gjë). Duke qënë jurist dhe jo mjek, unë sot me modesti dua të tregoj situatën e recidivizmit penal në Shqipëri, si dhe “ilaçet” tona të mundshme për përmirësimin e gjendjes.

**Recidivizmi në drejtësinë penale nuk është gjë tjetër, veçse “tendenca”apo “moda”e rikthimit në gjendjen e mëparshme kriminale.**

## **1. Normat e recidivizmit në Shqipëri**

Siç raportohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për periudhën 2010-2014, ka një dinamikë të luhatshme të numrit të recidivizmit sipas kategorive (i përgjithshëm/ specifik) nga viti në vit dhe normat e recidivizmit për të burgosur/paraburgosur, të liruar e të rikthyer në sistemin e IEVP-ve janë:

- në vitin 2010 janë regjistruar 427 raste të recidivizmit;
- në vitin 2011 janë regjistruar 389 raste;
- në vitin 2012 janë regjistruar 375 raste;
- në vitin 2013 janë regjistruar 425 raste;
- në vitin 2014 janë regjistruar 406 raste.

Të dhënat tregojnë, se pjesa më e madhe e të dënuarve janë ri-arrestuar për kryerjen e veprave të tjera penale, krahasuar me veprën penale të dënuar më parë.

Në vija të përgjithshme, ndihet një rritje e lehtë dhe e luhatshme e recidivizmit të përgjithshëm (227- 290), si dhe një ulje e ndjeshme e recidivizmit specifik (209- 116).

A ka shteti ynë një normë jashtëzakonisht të lartë të recidivizmit? Shifrat tona, të krahasueshme me standartet ndërkombëtare, në përgjithësi tregojnë që jo. Një

analizë e shpejtë e të dhënave statistikore **nxjerr, në fakt, atë që na shqetëson më tepër:**

Rritja e recidivizmit tek të miturit (sado e vogël) me 24 raste në 2011, në 28 raste në 2012, në 35 raste në 2013 e duke përfunduar me 87 raste në 2014. Si dhe **përsëritja në rritje** e vjedhjeve, armëmbajtjes, trafikimit të lëndëve narkotike tek këto moshë.

## **2. Shkaqet e recidivizmit në Shqipëri**

I vetmi studim raportues/ statistikor i viteve 2009- 2014, ende pa një analizë profesionale të të dhënave, të krijon bindjen se gjetjet mbi shkaqet e recidivizmit janë po ato, të brendshme/ të jashtme në sistemin e drejtësisë penale, që shfaqen edhe në shoqëritë rreth nesh.

*Së pari*, kushtet e vështira të burgut, përfshirë dhe vetë izolim, ndikojnë në rritjen e recidivizmit.

Është e njohur, se aty ku mungojnë kushtet minimale standarde të burgosuritjanë të zhveshur nga të drejtat e tyre civile dhe janë të zhytur të bashkëjetojnë në komunitete, të cilat të tjetërsojnë në një botë të dënueshme.

*Së dyti*, kontribues të tjerë në recidivizmin penal janë vështirësitë që përballen në gjetjen e vendeve të punës, në marrjen me qera të banesave apo dhe marrjen e arsimit të nevojshëm dhe kredive arsimore.

Punëdhënësit, publikë apo privatë qofshin, shpesh refuzojnë të punësojnë të dënuarin ('kriminelin') dhe janë në mëdyshje të plotë për çdo pozicion që përfshin edhe përgjegjësitë më të vogla.

Njerëz ish- të dënuar raportojnë shpesh vështirësi apo paaftësi për të gjetur mundësitë e arsimit apo mohime të ndihmës financiare, bazuar në të dhënat e tyre personale.

## **3. Politikat tona alternative**

Ka alternativa të panumërta, që ne sot mund t'i marrim në konsideratë si një mjet për të zgjidhur problemin e recidivizmit. Të tjera alternativa botërore nuk kanë vlerë për tu eksploruar këtu, për shkak të kostos së lartë financiare, burimeve të munguara deri sot të financimit, apo dhe moskuptimit të rëndësisë së problemit. Për ne nuk do të mungojë asnjëherë përfshirja në një rishikim të plotë të vlerave më të mira njerëzore, që kanë të bëjnë me drejtësinë penale, dënimin penal, si dhe dhënien reale të "shansit të dytë".

**Tre alternativat tona të mundshme për tu konsideruar në këtë tryezë janë:**

1. Të lejojmë trendet aktuale të vazhdojnë, pa ndërhyrjen tonë (thjesht ruajtjen e status-quo-së);

2. Të rrisim praninë dhe cilësinë e shërbimeve, përpara lirimit nga burgu, brenda objekteve të skemës së sigurisë së IEVP-ve, nisur nga faktorët ndihmës që lidhen me trajtimin e të miturve, përdoruesve të drogës, të sëmurëve mendorë e deri tek programet e nevojshme të edukimit e trajnimit profesional;

**3. Të rrisim e kërkojmë praninë dhe cilësinë profesionale të organizatave me bazë komunitare që ofrojnë shërbime në këtë fushë të parandalimit dhe reduktimit të kriminalitetit në vend.**

Shumë ish- të dënuar nuk e kanë kapacitetin mendor për të mbështetur qëllimet e tyre arsimore dhe ekonomike. Shumicës dërrmuese të tyre, edhe formalisht, shpesh u mungon një rrjet social kolegësh të besueshëm si dhe anëtarë të familjes, të gatshëm për të marrë pjesë në/dhe për të mbështetur përpjekjet e tyre të tranzicionit social. Ne, si ministri e Drejtësisë, kemi kohë që përpiqemi për tu shkëputur nga sistemi i përqendruar **vetëm tek arresti dhe burgosja, duke injoruar rehabilitimin dhe riintegrimin** e duhur në komunitet të të dënuarve.

Deri më sot për këta recidivistë të mitur e të rinj, si edhe për më të rriturit, **rruga për në burg është shpesh më e qartë dhe më e mirështruar se rruga drejt punës, kolegjit apo fakultetit.** A e bëjmë dot së bashku të kundërtën?

Ka përpjekje për të krijuar programe që kushtojnë, por paratë jo domosdoshmërisht zgjidhin çdo problem. Një gjuhë më e qartë dhe më e thjeshtë është e nevojshme për të prodhuar rezultate të qarta.

Ajo çfarë ligjvënësi dhe publiku me të vërtetë duan të dinë në lidhje me sistemin e drejtësisë penale, është se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon dhe për të cilat arsye ndodh kjo. E bëjmë dot këtë? Përndryshe... kot sa mblidhemi e i flasim njëri-tjetrit.

Çdo “sëmundje” e diagnostifikuar mirë kërkon ilaçin e saj parandalues dhe shërues. Kjo tryezë duhet ta ofrojë atë.